



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar””. *(komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Eglantina Gjermani, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Klodi Mezini – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi - Përshëndetje!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi shqyrtimin e projektligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Jemi në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Dua t’ju njoftoj se kanë ardhur dhe katër marrëveshje të tjera, respektivisht:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë””, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010 për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr.89/2015”.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare- rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor”.

Për projektligjin “ Për mbrojtjen e konsumatorëve”, relator është zotin Vullnet Sinaj.

Janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Data e shqyrtimit në seancë plenare nuk është parashikuar.

Po, zoti Sinaj, mund të bëni një prezantim.

Vullnet Sinaj - Projektligji “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”” të ndryshuar ka të bëjë me plotësimin e detyrimeve të marra përsipër nga shteti shqiptar në kuadër të MSA-së për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së.

Në nenin 76 të saj, ndër të tjera përcaktohet se mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut. Kontrata të tilla, kur kanë të bëjnë me konsumatorin dhe tregtarin nga ana tjetër e kanë origjinën e rregullimit të tyre të legjislacioni europian, ku si qëllim është arritja substanciale e barazisë ndërmjet palëve në treg, duke ndikuar jo vetëm në konkurrencën e ndershme, por edhe në mirëfunksionimin e tregut. Projektligji i propozuar është parashikuar edhe nga Plani Kombëtar i Integritetit Europian 2016-2020, në faqet 885-887 të tij. Në këtë moment kërkohet përafrimi i legjislacionit në fushën e të drejtave të konsumatorëve dhe legjislacionin më të ri bashkëkohor të BE-së, konkretisht me direktivën 2011/83 BE, të Parlamentit Europian, Këshillit Europian, datë 25 tetor 2011 “Për të drejtat e konsumatorit”.

Projektligji që do të diskutojmë ka të bëjë me 2 transpozime: ai i direktivës 2011/83 BE “Të drejta e konsumatorit” dhe transpozimi i direktivës 2013/11 BE “Për zgjidhjen e alternativave të mosmarrëveshjes së konsumatorëve”. Përafrimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së është bërë edhe më parë, me miratimin e ligjit nr.8192, datë 6.02.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, duke vazhduar në vitin 2003 me miratimin e ligjit nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe më pas me ligjin nr.9902, datë 17.04.2008.

Në vazhdim jemi duke kërkuar për të bërë ndryshime të tjera që vijnë edhe nga kushtet e ndryshme në të cilat është sot tregu. Në ditët e sotme nuk jemi në të njëjtat kushte me tregun e mëparshëm, pasi teknologjia ka bërë punën e saj, nuk jemi në një treg tradicional të shitjes në qendrat tregtare, por kemi shitje edhe jashtë tyre, si në rrugë, në qendrat e punës apo në banesat e konsumatorëve, si edhe në largësi, nëpërmjet mjeteve më moderne të komunikimit, sikurse janë: televizioni, interneti. Pra, lindja e formave të reja të shitjeve dhe të shërbimeve jashtë qendrave tregtare apo në largësi kërkon një rregullim të posaçëm legjislativ, si edhe ndërtimin, mirërregullimin e elementeve të posaçme të së drejtës kontraktuale.

Ky projektligj përfaqëson përmirësimin e fazës së parë të përafrimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Pavarësisht se kjo fazë është kryer dhe ka pasur një përjasje të konsiderueshme që nga vitit 2008 zbatimi i direktivës 2011/83 BE “Për të drejtat e konsumatorëve” kërkon disa shtesa dhe ndryshime në legjislacion aktual, pasi edhe vetë direktiva e KE-së rrëzon një direktivë të mëparshme, atë të datës 17.04.2008, e cila është transferuar në ligjin e mëparshëm nr. 9902. Për këtë ligj ka pasur edhe dy VKM, të cilat bien me ligjin e ri, janë VKM-të nr. 63 dhe nr.64 të datës 21.01.2009.

Objekti i përgjithshëm i projektligjit është fuqizimi i konsumatorëve nëpërmjet informimit të tyre për shitjet dhe shërbimet që ofrohen në treg, si edhe një mbrojtje më e madhe për ta, duke siguruar që mosmarrëveshjet ndërmjet tyre dhe tregtarëve të trajtohen nga struktura jashtë gjyqësore, që ofrojnë procedura të zgjedhjes alternative të mosmarrëveshjeve, të paanshme, transparente, efektive dhe të drejta pa u kufizuar të drejtën konsumatorëve për t'iu drejtuar gjykatës, duke kontribuar në funksionimin e mirë të tregut të brendshëm.

Këtu qëndron edhe një nga risitë që ka ky projektligj, sepse përveç zgjidhjeve, gjykata jep zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve.

Si konkluzion i këtij vlerësimi është përzgjedhur opsioni që parashikon funksionimin e disa zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve të veçanta për sektorë të shërbimeve të interesit publik. Kjo siguron edhe kosto më të ulët për krijimin dhe funksionimin e një sistemi të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve. Për shembull, në nenin 52 është shprehur qartë se rolin e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve në energjinë elektrike e zgjidh Enti Rregullator i Energjisë Elektrike. Në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve me konsumatorin e kryen AKEP-i.

Projektligji ka parashikuar dispozita në lidhje me shtrirjen e mbrojtjes së konsumatorëve në nivel vendor, nëpërmjet delegimit të disa kompetencave të pushtetit vendor për mbrojtjen e konsumatorëve, kryesisht lidhur me informimin, ndërgjegjësimin dhe seleksionimin e ankesave të tyre në bashkëpunim të ngushtë me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve në nivel qendror.

Në funksionin e zgjidhjes së alternativave të mosmarrëveshjeve projektligji parashikon funksionet përkatëse për strukturat përgjegjëse që ushtrojnë zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve, si edhe autoritetin kompetent për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e këtyre funksioneve. Ai parashikon edhe dispozita të posaçme, të cilat garantojnë respektimin e 6 parimeve themelore të parashikuara nga direktiva 2013/11 BE, sikurse janë parimi i pavarësisë, i paanësisë, i profesionalizmit, i transparencës, i eficiencës dhe i ligjshmërisë.

Në funksion të opsionit të përzgjedhur për sa i përket zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, projektligji parashikon krijimin e një strukture përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit. Krijimi i kësaj strukture të përgjithshme që mbulon të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve të pambuluara nga entet specifike është kërkesë edhe e direktivës

2013/11 BE. Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vijueshmëri përgatit masat legislative dhe funksionin e mbrojtjes së konsumatorëve.

Ky projektligj ka përparësi në krahasim me ligjin aktual, për shembull, konsolidon dhe thjeshtëson listën e detyrimeve për informacion që duhet të japin tregtarët ndaj konsumatorëve në treg, konsolidon dhe qartëson kërkesat formale për kontratat jashtë qendrave të tregtimit dhe ato në largësi, rregullon me hollësi të drejtën për të hequr dorë nga kontratat e sipërcituara, mënyrën e ushtrimit të saj dhe pasojat e ushtrimit të kësaj të drejte dhe të tjera që janë në relacion.

Risite që sjell projektligji janë: ndryshimet në fushën e zbatimit të ligjit, duke parashikuar me qartësi zbatimin e këtij akti ligjor në raport me ligjet e tjera, detyrimi për informacion në kontrata të ndryshme nga ato të lidhura në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit, përfshirja në kontratë e detyrimeve për dhënien e informacionit, të drejtën e heqjes dorë nga kontrata dhe detyrimet e konsumatorit në rastin e heqjes dorë nga kontrata. I veçantë është parashikimi i dispozitave mbi funksionimin e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave dhe të respektimit të kriterëve në zgjidhjen e alternativave të mosmarrëveshjeve nga strukturat përgjegjëse. Kemi një strukturë përgjegjëse për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik pranë ministrisë.

Në këtë këndvështrim ngritja e strukturës përgjegjëse të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve do të përmirësonte aksesin e konsumatorëve ndaj mjeteve të thjeshta, efektive dhe pa kosto, si edhe do të sigurote që skemat e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve të jenë në dispozicion të të gjithë sektorëve të tregut të shitjes së mallrave dhe shërbimeve.

Për arsye të lënies së një afti kohor të mjaftueshëm, si edhe parashikimit të fondeve të nevojshme për ngritjen e kësaj strukture është përcaktuar krijimi i saj në vitin 2010, shoqëruar me hartimin e VKM-së përkatëse për organizimin dhe funksionimin. Për këtë qëllim kostot do të parashikohen në buxhetin e vitit 2020. Është parashikuar dispozita kalimtare që përcakton se funksionet e strukturës së propozuar do të kryhen nga Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve deri në krijimin e strukturës përgjegjëse, kostot e së cilës parashikohen të jenë rreth 15 milionë lekë, ku përfshihen arredimet e zyrave dhe pagat e punonjësve.

Janë të gjitha këto arsye që në njëfarë mënyre ne bëjmë detyrat që na ka caktuar Europa për të shkurtuar kohën e hyrjes në Europë për të përshtatur legjislacionin tonë me atë të BE-së.

Për risitë që sjell ky ligj, për ndryshimet në tregun shqiptar u propozoj kolegëve ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Sinaj për shpjegimet me detaje!

A ka ndonjë gjë nga përfaqësuesit e ministrisë?

Klodi Mezini - Do të bëja një përmbledhje shumë të shkurtër.

Zoti Sinaj i tha të gjitha. Ky projektligj është vetëm në favor të konsumatorit, është një detyrim, ka dalë si detyrim, sepse tregu ka evoluar. Jemi të detyruar të vendosim ekuilibra midis tregtarit dhe konsumatorit. Gjëja më e rëndësishme është zgjidhja alternative.

Ne sot të gjithë konsumatorët shqiptarë do t'i lehtësojmë në shërbimet më të rëndësishme që ata marrin: në kohë, në lekë dhe dispozicion. Që do të thotë se sot të gjitha entet rregullatore shtetërore do të kenë strukturat e tyre të posaçme, të cilat i kanë vendosur edhe në ligje specifike dhe do të merren vetëm me çështjen e mbrojtjes së konsumatorit. Ato do të jenë struktura të pavarura, transparente dhe do të monitorohen në mënyrën se si do t'u shërbejnë qytetarëve.

Kjo do të ngrejë edhe nivelin e shërbimeve në institucionet shtetërore, por në të njëjtën kohë do të rrisë dhe nivelin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Eduard Shalsi – Një nga objektivat e projektligjit ka të bëjë me informimin për produktet dhe shërbimet. Prej kohësh e kemi diskutuar dhe e kemi ngritur si shqetësim mungesën e një *website* ku lehtësisht konsumatorët me disa klikime të arrijnë të verifikojnë nëse një produkt, të cilin e ndeshin në treg, a është apo jo pjesë e katalogut të produkteve që tregtohen në Shqipëri.

Një nga objektivat është dhe fuqizimi i konsumatorëve nëpërmjet informimit të produkteve dhe shërbimeve. Ku jemi? Çfarë po bëhet në këtë drejtim?

Klodi Mezini - Ashtu siç e thatë edhe ju, një nga objektivat e ligjit është informimi i konsumatorit, që do të thotë se çdo tregtar ka detyrimin ligjor të informojë konsumatorin në rast se ai vë në treg një produkt apo një shërbim. Në rast se ju morët një shembull për blerjet *online*, në këtë rast...

Eduard Shalsi - Jo, nuk e kisha fjalën për blerjet *online*. Faktin që ju si konsumatorë...

Klodi Mezini - Ne trajtojmë çdo lloj ankese ku konsumatori ...

Eduard Shalsi - Ju lutem!

Një konsumator shkon pranë një dyqani, shikon një produkt dhe do të konsultohet, nëse ai është produkt i licencuar, është i rregullt apo jo. Ne kemi folur për një katalog të produkteve sipas specifikave që do të ekzistonte diku në *website*. Po flasim për faktin se sa lehtësisht një konsumator mund të informohet për një produkt që e has fizikisht dhe ta kontrollojë me *website*-in, me ministrinë dhe me strukturën përgjegjëse.

Klodi Mezini - Kemi qenë këtu bashkë kur kemi diskutuar për Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut dhe më në fund inspektorati është operacional në treg.

Ka një vit që është ngritur dhe operon në treg dhe detyrimi për të krijuar këtë listë, që e kemi quajtur lista e produkteve. Ata janë duke hartuar në bazë të inspektimeve që po bëjnë edhe listën e produkteve në *website*-in e tyre.

Eduard Shalsi – Dakord, është emëruar titullari i institucionit?

Klodi Mezini - Po, është zonja Ejana Xhixho.

Eduard Shalsi - Sekretaria teknike, mbajeni pak shënim në mënyrë që për këtë projektligj titullarit mund t'i kërkojmë një informacion se çfarë është bërë në një vit te kjo strukturë.

Ka ndonjë koleg që kërkon të flasë?

Nuk ka.

Votojmë sot projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”” në parim.

Si komisioni përgjegjës do të presim edhe opinionet e komisioneve të tjerave siç është Komisioni për Integrimin.

Ju lutem, duhet të mbani kontakt edhe me përfaqësuesit e ministrisë, por edhe me inspektoratet. Nuk e di nëse ka ndonjë konsultë që mund të bëjmë apo ndonjë grup interesi me të cilët mund të diskutojmë për mbrojtjen e konsumatorëve.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar””?

Kundër?

Nuk ka.

Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Rakip, ku janë sot përfaqësuesit e PD-së, a e ke idenë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rishihemi në orën 16:00 për të vazhduar shqyrtimin e projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

MBYLLET MBLEDHJA